



VENDIM

Nr. 44, Datë 12.04.2016

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “PHOENIX PETROLEUM” SH.A NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 4 pikat 50, 105, 107; neni 22 pika 2, gërma ‘ç’; neni 83 pika 2 e Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe neneve 4, pika 1, gërma “ç”; neni 8, neni 9 pika 1, pika 2, gërma ‘e’ dhe neni 10 pika 11 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Ndryshimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 9, datë 11.02.2011, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.04.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Phoenix Petroleum” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie;

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Ndryshimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërma ‘a’, ‘b’ dhe ‘c’) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 1 gërma ‘d’/i, d/ii, d/iv, d/v, d/vi) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale (neni 9, pika 1, gërma e/i, e/ii, e/iii, e/v, e/vi) janë plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni specifik për llojin e liçensës (neni 9, pika 2, gërma e/i, e/ii, e/iii),

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Liçensimin e shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., në aktivitetin e tregimit të gazit natyror për një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Liçensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 44, Datë 12.04.2016

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “PHOENIX PETROLEUM” SH.A NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË GAZIT NATYROR**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____